



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 31 /2021

Nr. Protokolli: 47/2021

Për:	MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË.
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	27.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 23.04.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: "MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Barëra" me Nr. të Prokurimi: 624-21-781-1-2-1 & 624-021-049-121 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 23.04.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik:: **MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, PRISHTINË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Barëra", kundër Njoftimi për Vendimin e AK –së, të datës 19 04.2021 të publikuar në platformen elektronike.
- II. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 19.04.2021.
- III. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **23.04.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit “**Furnizim me Barëra**” me Nr. të Prokurimi: **624-21-781-1-2-1 & 624-021-049-121**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës **19.04.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se me me dosje te tenderit, dhe se krahasimi i ofertave të bëra nga komisioni për vlerësim dhe krahasim është bazuar se disa çmime per pozicion kanë çmime të larta dhe disa të ulta, por duke bazuar në totalin e ofertes i njejti ka dhënë çmim të përaftër sipas planifikimit të njesisë së kërkesës. Poashtu edhe duke u bazuar në kontraten e vitit 2020-2021, ku afërsisht çmimet janë të ndryshme nga pozicione me çmime të larta dhe çmime shumë të ulta.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit

